



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 53

2001

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8824 datë 5.11.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së riskedulimit të borxhit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë”.....	1685
Ligj nr.8825 datë 5.11.2001	Për disa ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.....	1688
Ligj nr.8826 datë 5.11.2001	Për disa shtesa në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”.....	1689
Dekret nr.3069 datë 17.7.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare	1689
Vendim i KM nr. 624, datë 12.11.2001	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2001, miratuar për zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.....	1690

L I G J
Nr. 8824, datë 5.11.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË RISKEDULIMIT TË BORXHIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË TURQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e riskedulimit të borxhit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3147, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË TURQISË

Me këtë Marrëveshje Riskedulimi Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Shqipërisë (me poshtë referuar si MOF), dhe Banka Qendrore e Republikës së Turqisë (me poshtë referuar si CBRT) bien dakord të riskedulojnë borxhin që rrjedh nga Marrëveshja Ndërbankare e datës 20 shkurt 1987 ndërmjet CBRT-së dhe Bankës së Shtetit të Shqipërisë.

Tani dhe më pas, nën frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekonomik që ekziston ndërmjet të dy vendeve, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përbërja e shumës së borxhit të riskeduluar me këtë Marrëveshje Riskedulimi është si më poshtë:

- (a) Shuma e principalit është 3,413,872.43 USD.
- (b) Interesi i akumuluar deri më 31 mars 2001 është 1,713,308.31 USD.
- (c) Shuma e interes-vonesave deri më 31 mars 2001 është 456,647.50 USD.

Neni 2

Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër të paguajë shumën prej 5,127,180.74 USD (shuma e principalit së bashku me interesin e akumuluar) në një periudhë prej pesëmbëdhjetë vjetësh, përfshirë pesë vjet grace. Nga ana tjetër, CBRT bie dakord të falë shumën e interes-vonesave prej 456,647.50 USD.

Neni 3

CBRT, në librat e saj në Drejtorinë e Përgjithshme, do të hapë në emër të MOF-së një llogari në USD të quajtur "Llogaria e riskedulimit". Shuma prej 5,127,180.74 USD e cituar në Nenin 2, do të debitohet në "Llogarinë e riskedulimit" për t'u riskeduluar. Pas çdo pagese të principalit, "Llogaria e riskedulimit" do të kreditohet në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Mbi "Llogarinë e riskedulimit" do të llogaritet interes. Përqindja e interesit që do të zbatohet mbi gjendjen e "Llogarisë së riskedulimit" do të jetë LIBOR gjashtëmujor plus 0.50% në vit, siç kuotohet nga Barclays Bank Plc.Londër, në orën 11 paradite GMT, dy ditë pune përpara ditës së parë të punës të periudhës përkatëse të llogaritjes së interesit. CBRT-ja do të njoftojë MOF-në për këtë përqindje interesi të paktën një muaj përpara datës përkatëse të pagesës së interesit.

Interesi do të llogaritet mbi bazën e vitit prej 360 ditësh dhe për numrin faktik të ditëve.

Neni 5

Shuma prej 5,127,180.74 USD e "Llogarisë së riskedulimit" do të paguhet nga MOF me 20 këste të barabarta, të njëpasnjëshme gjatëmuajore; data e parë e pagesës do të jetë 1 tetor 2006.

Neni 6

Shuma e parë e interesit do të llogaritet për periudhën që fillon nga data e ratifikimit të Marrëveshjes nga Parlamenti Shqiptar, por jo më vonë se 1 tetor 2001, deri më 1 prill 2002, dhe do të paguhet më 1 prill 2002.

Me përjashtim të pagesës së parë të interesit, pagesat e interesit do të kryhen çdo gjashtë muaj. Duke filluar nga pagesa e dhjetë e interesit, pagesat e tij do të kryhen së bashku me pagesat e principalit.

Neni 7

Të gjitha pagesat do të kryhen nga ana e debitorit në ditën e parë të punës së çdo periudhe pagese në llogarinë e CBRT No. 10939927 me Citibank N.A. New York N.Y.USA.

Neni 8

Në rast se ndonjë pagesë nuk kryhet në datën e duhur, interesi i përcaktuar në Nenin 4 do të aplikohet mbi shumën e papaguar deri në datën faktike të kryerjes së pagesës.

Neni 9

CBRT do t'i dërgojë MOF- së njoftim për çdo hyrje të bërë në "Llogarinë e riskedulimit".

CBRT do të përgatisë gjithashtu njoftime gjashtëmuajore për këtë llogari dhe brenda dhjetë ditëve do t'ia dërgojë ato MOF- së për konfirmim.

Me marrjen e këtyre njoftimeve, MOF-ja do të konfirmojë gjendjen e Llogarisë ose, në qoftë se ka vërejtje, duhet t'ia dërgojë ato CBRT- së brenda dhjetë ditëve.

Në qoftë se CBRT-ja nuk merr përgjigje brenda dhjetë ditëve, atëherë gjendja e Llogarisë do të konsiderohet si e miratuar.

Neni 10

Çdo pagesë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Riskedulimi do të kryhet pa bërë asnjë zbritje për taksa, gjoba apo komisione të çdo lloji.

Neni 11

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve kontraktuese do të zgjidhen në përputhje me Rregullat e Arbitrit, të përcaktuara nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtar të Tregtisë (UNCITRAL), aktualisht në fuqi.

Neni 12

Korrespondenca për këtë Marrëveshje Riskedulimi do të mbahet në gjuhën angleze në adresat e mëposhtme:

- për Turkiye Cumhuriyet Merkez Bankasi
Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë
Drejtoria e Shkëmbimit të Legjislacionit
Istiklal Caddesi No.10
Ulus-Ankara-Turkey
Tel: 90-312-312 27 54
Fax: 90-312-310 91 02

- për Ministrinë e Financave
Drejtoria e Borxhit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Shqipëri
Tel: 355-4-22 84 05
Fax: 355-4-22 84 94

Neni 13

Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet miratimit nga të dyja palët dhe do të bëhet efektive kur palët të marrin njoftim nga njëri-tjetri për këtë çështje.

Bërë dhe nënshkruar në dy kopje në gjuhën angleze, të dyja autentike, në Ankara, më 21.9.2001

Për dhe në emër
të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë

Për dhe në emër
të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

L I G J **Nr. 8825, datë 5.11.2001**

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7664, DATË 21.1.1993 **“PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit” ndryshuar me ligjin nr.8364, datë 2.7.1998 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Mjedisit” dhe emërtimi “Kryetar i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Ministër i Mjedisit”.

Neni 2

Fjalja e fundit e paragrafit të parë të nenit 41 ndryshohet si më poshtë:
“Ministri cakton Kryeinspektorin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3148, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J **Nr. 8826, datë 5.11.2001**

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7564, DATË 19.5.1992 “PËR TË DREJTËN E AUTORIT”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me ligjet nr.7923, datë 19.4.1995, nr.8594, datë 6.4.2000 dhe nr.8630, datë 3.7.2000 bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në fund të nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) Përdorimi i pronësisë artistike, nga subjekte fizike dhe juridike, pa lejen e autorit, ose pa kontratë me shoqëritë e mbrojtjes së të drejtave të autorëve, shqiptarë dhe të huaj, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkuara nga Republika e Shqipërisë.

b) Mospagimi në afat i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave ose i autorizimeve midis autorëve shqiptarë ose të huaj ose shoqërisë që mbron të drejtat e tyre, me përdoruesit e pronësisë artistike.”.

Neni 2

Në fund të nenit 50/1 shtohet neni 50/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/2

Shkeljet e parashikuara në nenin 50/1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga inspektorët e kontrollit të Policisë Tatimore në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Këta inspektorë, përveç vjeljes së gjobave që parashikohen më poshtë, i detyrojnë përdoruesit të bëjnë edhe arkëtimin e të drejtës së autorit sipas këtij ligji. Gjobat janë si vijon:

1. Gjobë 100 000–400 000 lekë për përdoruesit e mëdhenj, si radiot dhe televizionet kombëtare, hotelet, prodhuesit (botuesit) e kasetave, videokasetave, kompaktdisqeve (CD), si dhe përdorues të tjerë të pronësisë artistike në fushat e letërsisë, arteve vizuale e fotografisë artistike.

2. Me gjobë nga 50 000–150 000 lekë për përdoruesit e mesëm, si radiot dhe televizionet lokale, diskotekat, pianobaret, restorantet me pistë për vallëzim, pubet, operatorët e internetit, telebingot dhe lojërat e tjera të fatit që zhvillohen me spektakle, sallat me destinacion tjetër, si Pallati i Kongreseve, stadione ose pallate sporti të lojërave me dorë, kur jepen me qira për koncerte.

3. Me gjobë nga 25 000–90 000 lekë për përdoruesit e vegjël, si kafenetë, baret, restorantet, tavernat, hotelet, motelet dhe sallat e gjimnastikës aerobike.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Në fund të nenit 50/2 shtohet neni 50/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/3

Gjobat e vjelura nga përdoruesit e pronësisë artistike në kundërshtim me ligjin kalojnë gjashtëdhjetë për qind në Buxhetin e Shtetit dhe dyzet për qind në llogari të shoqërive të autorëve.”

Neni 4

Në fund të nenit 50/3 shtohet neni 50/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/4

Ministri i Financave nxjerr udhëzim për mënyrën e kontrollit të përdoruesve të pronësisë intelektuale nga organet e Policisë Tatimore.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.3149, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 3069, datë 17.7.2001

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389,

datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Melida Muhamet Fatouros (Demiri)
2. Shahin Ruzhdi Agolli
3. Smeralda Shahin Agolli
4. Bora Shahin Agolli
5. Miranda Ahmet Agolli (Laçi)
6. Manuela Myslym Boukerma (Mara)
7. Rigers Eduard Ferzaj
8. Amin Ramdane Boukerma
9. Zina Luigj Maslak (Kakarriqi)
10. Sotir Harrilla Kotini
11. Sergio Sotir Kotini
12. Geri Sotir Kotini
13. Natasha Hazis Kotini (Miluka)
14. Sonila Muharem Rreshka
15. Eugen Ramadan Arapi
16. Davida Dedë Kola
17. Peruze Faik Xhemali (Hoxha)
18. Klajdi Muharrem Xhemali
19. Xhovalin Ndoc Lukaj
20. Jorsina Xhovalin Lukaj
21. Mark Xhovalin Lukaj
22. Burhan Yzeir Sejdia
23. Rovenat Agim Metani
24. Bardhyl Qemal Sufaj
25. Entela Nezmi Sufaj (Jakupi)
26. Xhorxhi Dhimosten Papa
27. Ferdinand Koli Qorri
28. Festim Rexhep Horanlli
29. Jacqueline Festim Horanlli
30. Janine Festim Horanlli
31. Lindita Çelo Horanlli (Zhupa)
32. Eduard Fadil Xhindi
33. Cornelia Eduard Xhindi
34. Kevin Eduard Xhindi
35. Sofia Nexhip Xhindi (Balli)
36. Marta Llesh Kühling (Zadeja)
37. Majlinda Avdyl Toska
38. Ilmi Barjam Likaj
39. Dolantina Halil Likaj (Hizmaj)
40. Klodian Ilmi Likaj
41. Ida Ilmi Likaj
42. Aleksandër Muhamet Laho
43. Ardian Sabri Hoxha
44. Sabrina Ardian Hoxha
45. Kevin Ardian Hoxha
46. Sendi Ardian Hoxha
47. Stela Jonuz Hoxha (Stafa)

48. Niko Loni Dimoshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 624, datë 12.11.2001

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2001, MIRATUAR PËR ZYRËN E
ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, në zërin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.11.2001
Doli nga shtypi më 20.11.2001

Tirazhi: 4210 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 100 lekë